



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac / Municipality Rahovec



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA




KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

-III- Nr. I prot. 2376 Më 01.07.2026
Br. prot. Dt. 2026
RAHOVEC - ORAHOVAC

RAPORTI 6-MUJOR I PUNËS

JANAR-QERSHOR 2026



2026

DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Aktivitetet e Drejtorisë së Shërbimeve Publike gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2026

RAPORT I PUNËS SË DREJTORISË SË SHËRBIMEVE PUBLIKE

Gjatë kësaj periudhe janë realizuar një sërë aktivitete në mirëmbajtjen dhe përmirësimin e infrastrukturës publike në territorin e Komunës së Rahovecit.

- Janë kryer intervenime në ndriçimin publik, përfshirë rregullimin e shtyllave dhe pajisjeve përcjellëse, si dhe ndërhyrje në ujëmbledhës, puseta, rrugë të dëmtuara dhe elemente të tjera infrastrukturore.
- Janë realizuar intervenime emergjente për deblokimin e rrugëve në Kaznik, Fortesë, Brestoc, Pastasel, Kramovik dhe Xërxë, si dhe pastrimi i rrugëve dhe trotuareve pas vërshimeve.
- Është bërë grumbullimi i mbeturinave në disa zona të komunës.
- Janë trajtuar çështje që lidhen me rregullimin e kablllove të kamerave të sigurisë dhe vendosjen e sinjalistikës rrugore.
- Në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) është dorëzuar lista e përroskave që kërkojnë ndërhyrje dhe pastrim.
- Është përfunduar vlerësimi vjetor i stafit të Drejtorisë për vitin 2025, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Janë trajtuar gjithsej 202 kërkesa, prej të cilave 143 janë miratuar, 42 janë refuzuar, 16 janë në proces dhe 1 është anuluar. Të gjitha lëndët janë ngarkuar në sistemin e Intranetit.
- Ka filluar largimi i deponive ilegale në Fortesë, përgjatë rrugës rajonale Rahovec–Suharekë dhe në aksin Sarosh–Pastasel.
- Ka përfunduar krasitja e drunjve dekorativë dhe pastrimi i vegjetacionit në qytet dhe në zona të tjera.
- Ka përfunduar rregullimi i trotuarit në rrugën “Vëllezërit Haradinaj”.
- Kanë filluar punimet në rrugën Sarosh–Rahovec, ku aktualisht po realizohet nënbaza e rrugës.
- Në projektin e rrugës me katër korsi kanë filluar përgatitjet për largimin e rrjetit elektrik dhe shtyllave ekzistuese.
- Kanë vazhduar punimet në rrugën Sapniq–Nashpallë–Vrajak, ku pas përfundimit të lëshesave gypore do të vijojë asfaltimi.
- Janë larguar deponitë ilegale të mbeturinave në rrugën e Hamocit dhe në rrugën Transit.

- Po vazhdon pastrimi i kanaleve dhe përroskave në Malësi të Vogël, Xërxë, Zoqishtë dhe lokalitete të tjera sipas nevojës.
- Janë vendosur të dhënat në Sistemin e Performancës nga Drejtoria e Shërbimeve Publike.
- Janë përfunduar të gjitha kërkesat e adresuara për muajt janar, shkurt dhe mars përmes platformës Intranet.
- Janë përfunduar 6 gropa septike, projekt i bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian përmes programit IPA, në partneritet me Komunën e Haraçinës, Maqedonia e Veriut.
- Kanë rifilluar punimet për ndërtimin e rrugëve lokale. Është në përfundim ndërtimi me elemente betoni i një rruge me gjatësi prej 175 metrash në fshatin Gexhë. Gjithashtu, janë drejt përfundimit edhe dy segmente të tjera rrugore, pas së cilave punimet do të vazhdojnë në vendbanime të tjera të komunës.
- Ka filluar zbatimin e projektit për ndërtimin e 6 gropave septike sipas kontratës së nënshkruar, me punimet që kanë nisur në fshatrat Drenoc dhe Senoc.
- Janë larguar disa deponi ilegale të mbeturinave, përfshirë një në zonën urbane, si dhe në lokacione të tjera ku është paraqitur nevoja për intervenim.
- Është intervenuar në rrugën “Vëllezërit Haradinaj” për rregullimin e rrjetit të kanalizimit dhe evitimin e problemeve të paraqitura në terren.
- Është mbajtur një konferencë me rastin e Ditës së Tokës, ku gjithashtu është lansuar platforma për raportim online të problemeve mjedisore, me qëllim të rritjes së pjesëmarrjes qytetare në mbrojtjen e mjedisit.
- Kompania KRU Gjakova ka filluar aktivitetet për mbushjen dhe sanimin e gropave në rrugë me asfalt, në lokacionet ku janë kryer intervenime në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit.
- Janë përfunduar të gjitha kërkesat e adresuara në Drejtorinë e Shërbimeve Publike përmes platformës Intranet.
- Kemi intervenuar në rregullimin e disa pushtave në rrugët “Bekim Isma”, “Dëshmorët e Pashtrikut”, si dhe në lagje të tjera të komunës.
- Po vazhdon projekti për ndërtimin e 6 gropave septike sipas kontratës, me punimet që po zhvillohen në Drenoc dhe Senoc.
- Është bërë kërkesë zyrtare për vazhdimin e memorandumit për realizimin e projektit të rrugës Fortesë–Celinë.
- Është përfunduar auditimi i brendshëm në drejtori për periudhën janar–dhjetor 2025.

SFIDAT E DREJTORISË SË SHËRBIMEVE PUBLIKE PËR VITIN 2026

1. Sfidë e vazhdueshme për Drejtorinë mbeten kërkesat e shumta për ndërtimin dhe asfaltimin e rrugëve lokale, rrugëve dytësore dhe atyre të pakategorizuara në të gjithë territorin e komunës.
2. Një tjetër sfidë e rëndësishme vazhdon të jetë menaxhimi i mbeturinave të amvisërisë dhe mbeturinave inerte, të cilat shpesh hidhen në vende të papërshtatshme duke krijuar deponi ilegale. Pavarësisht angazhimit të vazhdueshëm të Komunës së Rahovecit për pastrimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave publike, ky problem mbetet ende prezent.
3. Furnizimi me ujë të pijshëm për vendbanimet ku ende nuk është shtrirë rrjeti i furnizimit nga KRU "Gjakova" vazhdon të jetë një ndër prioritetet dhe sfidat kryesore.
4. Sfidë e rëndësishme mbetet edhe furnizimi i qëndrueshëm me energji elektrike, rigjenerimi dhe modernizimi i rrjetit ekzistues, si dhe adresimi i kërkesave të shumta të qytetarëve lidhur me këtë sektor.

Me përkushtim të plotë, Drejtoria e Shërbimeve Publike do të vazhdojë angazhimin e saj për përmirësimin e infrastrukturës publike, rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe krijimin e kushteve më të mira për të gjithë qytetarët e Komunës së Rahovecit.

Drejtori i DShP-së

Përparim Krasniqi